



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

NJËSIA E PROKURIMIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Procedurës: ***Mobilim dhe pajisje per qendren e moshave te treta (projekti as ne te mos mbetemi pas).***

REF-96781-02-28-2024

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 39150000-8

Vlera e Fondit Limit: **1.187.500** (nje milion e njeqind e tetedhjte e shtate mije e peseqind)Lekë , **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimin e APP nr. 8 datë 05.10.2022 “Për miratimin e dokumentave standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit "procedurë e hapur e thjeshtuar" VKB-ne Nr.65 date 22.12.2023 „Per miratimin e buxhetit te Bashkise Kukes per vitin 2024“, si dhe shkreses nr.136 dt 10.01.2024 “Dergohet regjistri i pokurimeve publike per vitin 2024“ , sot më datë 28/02/2024 u mbledh Njesia e Prokurimit *(me perberje te plote)* për hartimin e dokumentacionit të prokurimit autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kukës ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 26, dhe të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP 1“. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave,

autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1 Operatori ekonomik duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe vërtetuar nëpërmjet ekstraktit të regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 40, neni 43 dhe neni 55 pika 4, të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, “ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar ...”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 237.500 lekë të vlerës së përllogaritur të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*
ose

b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe*

të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4, neni 55, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar **minimalisht 3 (tre)** punonjës, punonjësit e mëposhtëm marangoz/karpentier duhet të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesionale, çertifikata, diploma të shkollës profesionale përkatëse për specialitetin marangoz, të lëshuar nga institucione të licensuara nga organet përkatëse. Për këta punonjës të paraqitet dëshmia profesionale përkatëse, kontratë pune. Ndërsa për punonjësin shofer të paraqitet leja drejtimit të mjetit përkatëse sipas kategorisë së përcaktuar në ligj për mjetet me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton dhe kontratë pune.

- Marangoz 1 (një)
- Punonjës ndihmës 1 (një)
- Shofer 1 (një)
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të dekluarar.
- Kontratë Pune.
- Dëshmi kualifikimi profesionale, çertifikata, diploma të shkollës profesionale përkatëse të lëshuar nga institucione të licensuara nga organet përkatëse.
- Leje Drejtimi sipas kategorisë së përcaktuar në ligj për mjete me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm

për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 1 (një) mjet transporti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mallrash. Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit, dhe çertifikate për transportë mallrash brenda vendit.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira, të disponohet kontrata e qirasë, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, si dhe polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit dhe çertifikate për transportë mallrash për të tretë dhe me qera brenda vëndit.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të pika 5/ç të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion 1 mjet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Mjetet e mësipërm janë të domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj i shërben Autoritetit Kontraktor për tu njohur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën 1 vjecare të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre.

2.3.5.Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin dhe montimin e mallit pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit Nr.75 datë 29.01.2024 Për përlllogaritjen e fondit limit dhe për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi (paraqitur me proces-verbalin nr.1001prot datë 16.02.2024), përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Specifikimet)

Bashkia Kukës për nevojat e saj kërkon të realizojë prokurimin me objekt: **“Mobilim dhe pajisje për Qendrën e Moshave të treta” projekti “As ne të mos mbetemi pas”**,

Kërkesa të Përgjithshme:

Kërkesa është që materialet të jenë cilësore dhe praktike për moshën e tretë

- 1. Tavolina 15 copë – përmasat 110 me 110 cm lartësia 80 cm, material druri, me 4 këmbë, ngjyre e errët.**
- 2. Karrige 100 copë, përmasat standarde, material dru, ulësja me material sfungjer te butë e veshur me copë të errët në përshtatje me ngjyrën e tavolinës.**
- 3. Banak, copë 1, përmasat rreth 2 metër linear së bashku me një këndore material dru, i përshtatshëm për një minikuzhinë me lavaman, mbajtëse gotash, filxhanash, vend për vendosjen e ekspresit te kafesë, zyrtarë për matjen e ndihmës së shpejtë dhe aparatin e tensionit.**
- 4. Kondicioner 24 BTU, tensioni 220 – 240 V, i montueshëm lart në mur, me kapacitet ngrohës dhe ftohës, me parametra kursim energjie me inverter, me funksion vetëpastrimi, me nivel zhurme të ulët.**
- 5. Aspirator muri për qarkullimin dhe pastrimin e ajrit nga pirja e duhanit, parametrat të jetë i përshtatshëm për një ambient rreth 60 m², i montueshëm në mur.**
- 6. Televizor – 2copë, rreth 55 polësh, me montim ne mur në dy anët e ambientit të brendshëm, plazma, me pult, të përshtatshëm për lidhje me fish kabull interneti dhe kabllori gjithashtu.**
- 7. Ekspres kafeje, i përshtatshëm për ekspres dhe lloje te tjera kafesh dhe çaji, të ketë të përshirë dhe kafen, sheqerin dhe gotat e kartonit për 50 kafet e para të përdorimit të aparatit të kafesë**
- 8. Makine uji, ne formë frigoriferi me prize, pra me korent, me bidon uji deri në 25 litra, bashkë me gota njëpërdorimshme**
- 9. Grila dritaresh të brendshme me shinë, me fleta të cilat hapen e mbyllen manualisht për dritën e diellit, për 4 dritare me përmasa 3.10 metër gjatësi dhe 2.25 m gjerësi.**

Material i lakueshëm të cilat hapen 180 gradë, sipas reflektimit të ditës. Shembull figura



10. Paketa shëndetësore (Termometër, Oksimeter, Aparat për matjen e tensionit), dy sete. Termometër të thjeshtë për matjen e temperaturës si dhe aparat cilësor tensioni.

- *Subjektet ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të marrin përsipër që të realizojnë kontratën objekt prokurimi, sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor (AK).*
- *Shërbimi duhet të plotësojë kërkesat themelore të cilësisë dhe standardit*

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Mobilim dhe pajisje për Qendrën e Moshave të treta dhe mjete Kampe shëndetësore” projekti “As “ne” të mos mbetemi pas”**. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.